



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK FIER
KRYESIA

Nr. 14393

Fier në 18.12.2025

VENDIM NR. 31 DATË 18.12.2025

PËR MIRATIMIN E RENDIT PARAPRAK TË DITËS PËR MBLEDHJEN E DATËS

Kryesia e Këshillit Bashkiak Fier në zbatim të Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 27 datë 15.04.2020 "Për miratimin e rregullores së Këshillit Bashkiak, rregullores për Konsultimet Publike dhe Kodin e Sjelles për funksionimin e Këshillit", Kreu 2, neni 22 "Kryesia e Këshillit" neni 1, 3, 4

VENDOSI:

1-Miratimin e Rendit paraparak të Ditës për mbledhjen e radhës së Këshillit Bashkiak, e cila do të zhvillohet në datën 22.12.2025 ora 13.00. Bashkëlidhur këtij vendimi gjenden pikat e Rendit paraparak të Ditës.

2-Ngarkohet Sekretari i Këshillit Bashkiak për publikimin e njoftimit të Rendit të Ditës, si dhe njoftimin e Këshilltarëve, Kryetarit të Bashkisë dhe çdo personi tjetër të interesuar për pjesëmarrje në mbledhjen e Këshillit Bashkiak.

3-Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYESIA E KËSHILLIT

1-Antoneta Çunaj

2-Arben Çuko

3-Fatbardha Merkaj

4-Evis Sema

5-Kreshnik Dapi

6-Endri Jaupaj

7-Rrapi Gjika



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I BASHKISË FIER

Nr. 14377 Prot.

Fier, më 14.12 2025

Lënda: Njoftim mbi zhvillimin e mbledhjes së radhës të Këshillit Bashkiak

Drejtuar: ANËTARËVE TË KËSHILLIT BASHKIAK FIER

Për dijeni: KRYETARIT TË BASHKISË FIER

PREFEKTIT TË QARKUT FIER

Në mbështetje të nenit 53, pika 4, nenit 56, pika 2, shkronja "a" të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, ju njoftojmë thirrjen e mbledhjes së radhës së Këshillit Bashkiak Fier, e cila do të zhvillohet në sallën e këshillit **ditën e Hënë, datë 22.12.2025, ora 13:00**, me këtë rend dite:

1. **Miratimi i Rendit të Ditës.**

2. **Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Këshillit, datë 11.12.2025.**

3. **Projekt-vendim:** : "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6 %, për muajin nëntor 2025."

Komisioni përgjegjës: Komisioni i Mirëqenies Sociale, Rinisë, Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit, të Drejtave të Njeriut, Infrastrukturës dhe Strehimit.

4. **Projekt – vendim:** "Për miratimin e bursave të shtetit për nxënësit që ndjekin programet mësimore në arsimin parauniversitar publik, për vitin arsimor 2025–2026."

Komisioni përgjegjës: Komisioni i Mirëqenies Sociale, Rinisë, Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit, të Drejtave të Njeriut, Infrastrukturës dhe Strehimit

5. **Projekt – vendim:** "Për miratimin e projektit 'Rehabilitim i sistemit ujitës me degën e Pojanit skema FRU-1'."

Komisioni përgjegjës: : Komisioni i Ekonomisë Vendore, Financave, Buxhetit, Taksave, Tarifave, Pasurive Bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, Mbikqyrjes Financiare.

6. **Projekt – vendim:** “Për miratimin e tabelës me të dhënat e listës emërore të pronave dhe pronarëve që do të shpronësohen për interes publik, për pasuritë e paluajtshme pronë private që preken nga realizimi i projektit ‘Zgjerimi i varrezave publike, faza VII’, fshati Mbyet, zk. 2637, Njësia Administrative Portëz, Bashkia Fier.”

Komisioni përgjegjës: Komisioni i Ekonomisë Vendore, Financave, Buxhetit, Taksave, Tarifave, Pasurive Bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, Mbikqyrjes Financiare.

7. **Projekt – vendim:** “Për një ndryshim në përdorimin e fondit të kushtëzuar për mbrojtjen civile, për vitin 2025, Bashkia Fier.”

Komisioni përgjegjës: Komisioni i Ekonomisë Vendore, Financave, Buxhetit, Taksave, Tarifave, Pasurive Bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë dhe Mbikqyrjes Financiare.

8. **Diskutime dhe komente.**

Kryetar Këshilli
Antoneta Cunaj

